VENDIM
Nr.1116, datë 13.11.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË "ARKITEKTURË –URBANISTIKË", NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010, NË KËTË PROGRAM STUDIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.1, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, të programit të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës në "Arkitekturë-urbanistikë".
2. Në përfundim të këtij programi studimesh lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor (Dr.) në arkitekturë-urbanistikë".
3. Ky program studimi e fillon veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
4. Kohëzgjatja e këtij programi të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite akademike, ku përfshihen edhe 60 kredite për studime të organizuara.
5. Kuota e pranimit në këtë program studimi, për vitin 2009, është 14, nga e cila dy kuota caktohen për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
6. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.
7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit Politeknik të Tiranës.
8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha